

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zjarret përfshijnë disa qarqe të vendit, betejë me flakët në Dajt dhe Fier
ADRESA	https://zeri.ai/live-updates-zjarret-perfshijne-disa-qarqe-te-vendit-beteje-me-flaket-ne-dajt-dhe-fier-i246927
BURIMI	zeri.ai
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 16:34:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 15:16:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6ecd75875225d9d03995900a55c892fef4cb4fe95c02f8c6de4f71bfeb02a405
TEKSTI	b0d1feaae9345e3258d33328cb9e186aa5bc1d76e7e6b58c685e605f0e5d6400
PAMJA	6806d2d1aa2a6f05c42918a51eeead8d1cc7a784903ad0cf5296e8c210b3ca0a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fc41be43d452464ec043f7f91833bfe5ea7f1292285025a234d38258bf213923
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af509d61787472ec8e41e2e6baaa0db3fd07d4af4f7a54c9293cb47ba3acab88
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fc41be43d452464ec043f7f91833bfe5ea7f1292285025a234d38258bf213923>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Të fundit](#)
- [Aktualitet](#)
- [Politikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Bota](#)
- [Energji & Mjedis](#)
- [Qytetërim](#)
- [Opinione](#)
- [Video](#)

-
-
-



[LIVE UPDATES](#)

Zjarret përfshijnë disa qarqe të vendit, betejë me flakët në Dajt dhe Fier

♦ Zjarret në Shqipëri vijnë të mbeten ende aktive. Situata më problematike vijon të mbetet në Dajt edhe në Fier. ♦Një zjarr i përmasave të mëdha është regjistruar gjatë mesnatës në një prej pikave më të njohura turistike në vend, në Syrin e Kaltër, bashkia Finiq. ♦Vendi edhe sot vijon të jetë nën 'pushtetin' e zjarreve, ku në 24 orë janë regjistruar 32 vatra, nga të cilat 11 mbeten aktive, 5 janë nën mbikëqyrje dhe 16 janë fikur. ♦Një zjarr me përmasa të konsiderueshme ka përfshirë zonën pyjore të Dërmenasit, pranë grykëderdhjes së lumit Seman në Fier, duke ngritur alarmin për përhapjen e flakëve drejt masivit me pisha. ♦ Pasditen e kësaj të diele është regjistruar në fshatin Borje, në njësinë administrative Shishtavec të Kukësit,një vatër zjarri duke përfshirë një sipërfaqe të mbuluar me dëllinja. ♦Situata e krijuar nga zjarri në zonat e Bardhajt dhe Myselimit në Shkodër po shkon drejt stabilizimit, pasi ndërhyrja e forcave në terren dhe nga ajri ka bërë të mundur vendosjen nën kontroll të vatrave më problematike. ♦Një zjarr me përmasa të mëdha vijon të përfshijë zonën pyjore të Semanit në Fier, ku janë identifikuar katër vatra aktive që po përhapen me shpejtësi për shkak të erës së fortë. ♦Në kodrat e fshatit Peshkëpi në bashkinë e Selenicës një vatër zjarri është aktivizuar duke përfshirë një zonë me bimësi shkurre dhe duke ngritur shqetësime për përhapjen e flakëve. ♦Është përfshirë nga flakët fshatin Kropisht në bashkinë Selenicë të qarkut Vlorë, duke krijuar një situatë të vështirë për ekipet që po operojnë në terren. ♦Përpjekjet për vënien nën kontroll të zjarreve në territorin e Bashkisë Lezhë vijnë në zonën e Tale, Bërzanë, Rrilë dhe Ishull, ndërsa një nga zonat më problematike mbetet Kalivaçi, ku forcat e angazhuara po përballen me një terren të vështirë që po e komplikon ndërhyrjen. ♦Në zonën e Kodrës së Krastës në Elbasan është regjistruar një vatër zjarri këtë të diel, ku flakët iu afruan dy banesave dhe detyruan një ndërhyrje të menjëhershme të shërbimeve zjarrfikëse.♦Zjarri është shfaqur në masivin pyjor të Tërbutit në Pukë, vetëm pak ditë pasi e njëjta zonë u përball me një nga zjarret më të mëdha të kësaj vere, që përfshiu mijëra hektarë sipërfaqe pyjore.

11 artikuj për këtë temë.
1 ORE ME PARE

Pukë, vatër zjarri në Tërbut, dyshohet për zjarrvënie

Zjarret përfshijnë disa qarqe të vendit, betejë me foto nga vendi i ngjarjes

PUKË- Një vatër e re zjarri është shfaqur në masivin pyjor të Tërbutit në Pukë, vetëm pak ditë pasi e njëjta zonë u përball me një nga zjarret më të mëdha të kësaj vere, që përfshiu mijëra hektarë sipërfaqe pyjore.

Zjarri është konstatuar në një pjesë tjetër të masivit, ndërsa terreni i thyer dhe bimësia e dendur po favorizojnë përhapjen e flakëve dhe po e bëjnë më të vështirë ndërhyrjen e ekipeve në terren.

Sipas informacioneve paraprake, ekzistojnë dyshime se vatra mund të jetë shkaktuar nga zjarrvënie e qëllimshme, megjithatë shkaqet e sakta pritet të përcaktohen pas verifikimeve që do të kryejnë autoritetet.

Ndërkohë, shërbimi zjarrfikës është nisur drejt zonës për të izoluar flakët dhe për të parandaluar përhapjen e tyre në pjesë të tjera të masivit pyjor.

Situata në Tërbut mbetet nën monitorim, ndërsa forcat e emergjencës vijnë të jenë të angazhuara edhe në vatra të tjera zjarri të raportuara në zona të ndryshme të vendit./**ZËRI**

1 ORE ME PARE

Zjarr në Krastë të Elbasanit, dy shtëpi rrezikohen nga flakët (VIDEO)

Zjarret përfshijnë disa qarqe të vendit, betejë me

ELBASAN- Në zonën e Kodrës së Krastës në Elbasan është regjistruar një vatër zjarri këtë të diel, ku flakët iu afruan dy banesave dhe detyruan një ndërhyrje të menjëhershme të shërbimeve zjarrfikëse. Në operacion u angazhuan tre mjete zjarrfikëse dhe 12 efektivë, të cilët përqendruan punën në krijimin e një perimetri sigurie për të penguar avancimin e zjarrit drejt zonës së banuar.



Pas ndërhyrjes së forcave në terren, vatra u vu nën kontroll, duke shmangur dëmtimin e banesave të rrezikuara. Fatmirësisht, nga ngjarja nuk raportohet për persona të lënduar, ndërsa autoritetet po vijnë të verifikimet për shkaqet që çuan në aktivizimin e zjarrit./**ZËRI**

2 ORE ME PARE

Zjarret në Lezhë, Ndreu: Situata mbetet e vështirë në Kalivaç, operacioni vijon

Zjarret përfshijnë disa qarqe të vendit, betejë me FOTO

LEZHË- Përpjekjet për vënien nën kontroll të zjarreve në territorin e Bashkisë Lezhë vijnë në zonën e Tale, Bërzanë, Rrilë dhe Ishull, ndërsa një nga zonat më problematike mbetet Kalivaçi, ku forcat e angazhuara po përballen me një terren të vështirë që po e komplikon ndërhyrjen. Në terren po punojnë strukturat zjarrfikëse dhe ekipet e angazhuara në operacion, me synimin për të frenuar përhapjen e flakëve dhe për ta mbajtur situatën nën kontroll.

Përmes një reagimi në rrjetet sociale, kryebashkiaku i Lezhës, Pjerin Ndreu, ka bërë të ditur se operacioni po vijon pa ndërprerje, pavarësisht vështirësive që paraqet zona.

Vazhdojmë betejën në Kalivaç, në një terren tepër të vështirë!, shkruan Pjerin Ndreu.

Autoritetet vijnë monitorimin e situatës, ndërsa operacioni në Kalivaç mbetet në fokus për shkak të terrenit të thyer dhe sfidave që po hasen në shuarjen e flakëve./**ZËRI**

2 ORE ME PARE

Zjarr në Kropisht të Vlorës, flakët shtrihen në 1.5 kilometra, kërkohet ndërhyrje nga ajri

Zjarret përfshijnë disa qarqe të vendit, betejë me

foto nga zjarri


VLORE- Është përfshirë nga flakët fshatin Kropisht në bashkinë Selenicë të qarkut Vlorë, duke krijuar një situatë të vështirë për ekipet që po operojnë në terren. Sipas informacioneve nga vendngjarja, flakët janë përhapur në një front prej rreth 1.5 kilometrash, ndërsa terreni i vështirë po e bën më të ndërlikuar ndërhyrjen nga toka.

Në operacion janë angazhuar zjarrfikësit e Selenicës, të mbështetur edhe nga forcat zjarrfikëse të Vlorës, të cilat janë thirrur në ndihmë për shkak të përmasave të zjarrit. Për shkak të përhapjes së shpejtë të flakëve dhe kushteve në terren, është kërkuar edhe ndërhyrja nga ajri, me synimin për të izoluar vatrën dhe për të shmangur avancimin e zjarrit në zona të tjera.

Autoritetet vijojnë operacionin për vënien nën kontroll të situatës, ndërsa deri në këto momente nuk raportohet për të lënduar./ZËRI

4 ORE ME PARE

Selenicë/ Zjarri përfshin kodrat e Peshkëpisë




SELENICË- Në kodrat e fshatit Peshkëpi në bashkinë e Selenicës një vatër zjarri është aktivizuar duke përfshirë një zonë me bimësi shkurre dhe duke ngritur shqetësime për përhapjen e flakëve. Sipas informacioneve nga terreni, era po favorizon avancimin e zjarrit, ndërsa terreni kodrinor po e bën më të vështirë ndërhyrjen për izolimin e vatrës.

Forcat zjarrfikëse pritet të ndërhyjnë për vënien nën kontroll të flakëve, ndërsa autoritetet po mbajnë situatën nën monitorim për të shmangur përhapjen e zjarrit në zona të tjera.

Deri në këto momente nuk janë bërë të ditura shkaqet që kanë çuar në rënien e zjarrit, ndërsa operacioni për shuarjen e tij pritet të vijojë në orët në vijim./ZËRI

4 ORE ME PARE

Flakët pushtojnë pyllin e Semanit, katër vatra zjarri aktive



FIER-Një zjarr me përmasa të mëdha vijon të përfshijë zonën pyjore të Semanit në Fier, ku janë identifikuar katër vatra aktive që po përhapen me shpejtësi për shkak të erës së fortë.

Situata mbetet shqetësuese, ndërsa forcat zjarrfikëse të Fierit ndodhen prej disa orësh në terren, duke punuar për izolimin e flakëve dhe parandalimin e përhapjes së tyre në pjesë të tjera të masivit pyjor.

Kushtet atmosferike po e bëjnë më të vështirë operacionin, pasi era po favorizon avancimin e zjarrit dhe po rrit rrezikun për përfshirjen e sipërfaqeve të tjera me bimësi.

Shërbimet e emergjencës vijojnë ndërhyrjen në terren, ndërsa deri në këto momente nuk raportohet për persona të lënduar. Autoritetet po monitorojnë nga afër situatën, me synimin për ta vënë plotësisht nën kontroll zjarrin në orët në vijim./ZËRI

4 ORE ME PARE

Shkodër/ Zjarri vihet nën kontroll, bonorët jashtë rrezikut




FOTO ILUSTRUESE

SHKODËR- Situata e krijuar nga zjarri në zonat e Bardhajt dhe Myselimit në Shkodër po shkon drejt stabilizimit, pasi ndërhyrja e forcave në terren dhe nga ajri ka bërë të mundur vendosjen nën kontroll të vatrave më problematike.

Flakët u riaktivizuan gjatë mesditës për shkak të erës së fortë, duke rritur shqetësimin për përhapjen e tyre pranë banesave. Megjithatë, sipas autoriteteve vendore, rreziku për zonat e banuara është shmangur.

Kryetari i Bashkisë Shkodër, Benet Beci, bëri të ditur se operacioni u zhvillua në mënyrë të koordinuar, me angazhimin e zjarrfikësve, Shërbimit Pyjor, Emergjencave Civile, Forcave të Armatosura, punonjësve të njësive administrative, vullnetarëve dhe banorëve të zonës.

"Pas një riaktivizimi të zjarrit, të favorizuar nga era gjatë mesditës, situata në Bardhaj dhe Myselim është drejt normalizimit dhe banesat janë jashtë rrezikut. Vatrat janë vënë nën kontroll falë ndërhyrjes së koordinuar nga toka dhe ajri," u shpreh Beci.


Operacioni u mbështet edhe nga dy helikopterë, të cilët ndërhynë mbi vatrat më të rrezikshme, duke ndihmuar në izolimin e flakëve dhe frenimin e përhapjes së tyre.

"Zona vijon të mbahet nën monitorim për të shmangur çdo riaktivizim të mundshëm," shtoi kryebashkiaku.

Edhe pse situata është përmirësuar ndjeshëm, autoritetet do të vijojnë monitorimin e zonës për të parandaluar rikthimin e flakëve në orët në vijim./ZËRI

5 ORE ME PARE

Zjarri në fshatin Borjen të Kukësit, era e fortë rrezikon banesat



KUKËS- Një vatër zjarri është aktivizuar pasditen e kësaj të diele në fshatin Borje, në njësinë administrative Shishtavec të Kukësit, duke përfshirë një sipërfaqe të mbuluar me dëllinja.

Flakët po përhapen me shpejtësi, të favorizuara nga era e fortë, ndërsa banorët e zonës janë angazhuar menjëherë në përpjekjet për të frenuar avancimin e tyre deri në mbërritjen e forcave zjarrfikëse.

Ndërkohë, automjeti zjarrfikës i Kukësit është nisur drejt vendngjarjes për të ndërhyrë në izolimin e vatrës dhe për të shmangur përhapjen e zjarrit në zona të tjera.

Sipas banorëve, shqetësimi kryesor mbetet afrimi i flakëve pranë banesave, pasi kushtet atmosferike po e bëjnë më të vështirë kontrollin e situatës. Autoritetet vijojnë ndërhyrjen në terren, ndërsa situata mbetet nën monitorim./ZËRI

5 ORE ME PARE

Zjarr përfshin pyllin në Dërmenas, flakët përparojnë në drejtim të pishave (VIDEO)




foto nga zjarri

DËRMENAS- Një zjarr me përmasa të konsiderueshme ka përfshirë zonën pyjore të Dërmenasit, pranë grykëderdhjes së lumit Seman në Fier, duke ngritur alarmin për përhapjen e flakëve drejt masivit me pisha.


Sipas informacioneve nga terreni, zjarri është aktiv në dy vatra të ndryshme në anën veriore të lumit, ndërsa era e fortë po favorizon avancimin e flakëve dhe po vështirëson ndërhyrjen.

Në vendngjarje kanë mbërritur forcat zjarrfikëse të Fierit, të cilat po punojnë për izolimin e vatrave dhe shmangien e përhapjes së zjarrit në pjesën më të dendur të pyllit.

Autoritetet vijojnë operacionin në terren, ndërsa situata mbetet dinamike për shkak të kushteve atmosferike që po favorizojnë përhapjen e flakëve./ZËRI

10 ORE ME PARE

Shqipëria në "flakë"! 11 vatra aktive: Himara në 'qetësi', Dajti, Shkodra dhe Fieri në 'luftë' me zjarret

Zjarrret përfshijnë disa qarqe të vendit, betejë me foto ilustruese

TIRANË-Vendi edhe sot vijon të jetë nën 'pushtetin' e zjarreve, ku në 24 orë janë regjistruar 32 vatra, nga të cilat 11 mbeten aktive, 5 janë nën mbikëqyrje dhe 16 janë fikur. Vatrave problematike janë ato në Dajti, Shkodër e Fier, ku flakët e zjarrit po përhapen me shpejtësi. Ministria e Mbrojtjes njofton se në Malin e Dajtit janë angazhuar 77 forca ushtarake dhe 1 helikopter për shuarjen e zjarrit.

Zjarri në Fieri vijon prej tre ditësh, ku në terren ndodhen 13 automjete zjarrfikëse, 4 autobote, 55 efektivë, 90 forca të tjera, si dhe 90 ushtarakë, 1 helikopter dhe 1 Air Tractor. Edhe në Bardhaj të Shkodrës, vatra e zjarrit vijon të jetë aktive.

NJOFTIMI:

Ministria e Mbrojtjes - informim mbi situatën e zjarreve gjatë 24 orëve të fundit

Ministria e Mbrojtjes informon se gjatë 24 orëve të fundit janë raportuar 32 vatra zjarri, nga të cilat 11 mbeten aktive, 5 janë nën mbikëqyrje dhe 16 janë fikur.

Për përballimin e situatës është realizuar një angazhim i gjerë operacional në nivel kombëtar, me 735 forca vendore dhe 64 automjete zjarrfikëse. Forcat e Armatosura kanë mbështetur operacionet me 475 efektivë, 7 automjete zjarrfikëse, 4 helikopterë dhe 1 avion Air Tractor. Për ditën e sotme është parashikuar angazhimi i 160 forcave ushtarake në zonat ku ndërhyrja vijon.

Angazhimi kryesor është përqendruar në vatrave më problematike.

Në Malin e Dajtit, krahas strukturave bashkiake, sot janë angazhuar 77 forca ushtarake dhe 1 helikopter.

Në Bardhaj të Shkodrës, janë angazhuar 5 automjete zjarrfikëse, shërbimi pyjor, strukturat e emergjencave civile, si dhe mbështetje nga FA me 1 automjet zjarrfikës dhe 1 helikopter, ndërsa sot operacionit i shtohen 33 forca dhe 1 ambulancë.

Në Fier, janë përfshirë 13 automjete zjarrfikëse, 4 autobote, 55 efektivë, 90 forca të tjera, si dhe 90 ushtarakë, 1 helikopter dhe 1 Air Tractor. Sot vijon mbështetja me 33 forca.


Operacioni në Himarë është përmbyllur me fikjen e zjarrit, pas një mobilizimi të gjerë me 26 automjete zjarrfikëse, 120 efektivë, 40 vullnetarë, 67 forca bashkiake, 20 forca policore dhe 180 efektivë të FA me 2 helikopterë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) vijon të ndjekë në mënyrë të përpunueshme situatën në të gjithë territorin e vendit, në koordinim të ngushtë me prefekturat, bashkitë dhe të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile.

Kapacitetet operationale mbeten të angazhuara në terren dhe në gatishmëri për të ndërhyrë aty ku situata e kërkon, me prioritet mbrojtjen e jetës, banesave, pasurisë së qytetarëve dhe mjedisit.

11 ORE ME PARE

Zjarr në Syrin e Kaltër! Digjen 4 kioska tregtimi, flakët shuhen pas mesnate

Zjarrret përfshijnë disa qarqe të vendit, betejë me foto ilustruese

SARANDË-Një zjarr i përmasave të mëdha është regjistruar gjatë mesnatës në një prej pikave më të njohura turistike në vend, në Syrin e Kaltër, bashkia Finiq. Si pasojë e flakëve, raportohet se janë djegur plotësisht 4 kioska tregtimi private që ndodheshin në këtë zonë.

Menjëherë pas marrjes së njoftimit, në vendngjarje kanë shkuar 3 mjete zjarrfikëse dhe 2 mjete të policisë së bashku me efektivët. Fikja e plotë të zjarrit është bërë e mundur rreth orës 02:00 të mëngjesit. Nga hetimet paraprake të autoriteteve, dyshohet se shkak i rënies së zjarrit ka qenë një masë elektrike./ZËRI

TE NGJASHME

•

LIVE UPDATES

[Vijon "lufta" me flakët nga veriu në jug! Vatra zjarri në Fier e Shkodër, Himara merr frymë pas "ferrit"](#)

5 Shtator 2026, 13:10

LIVE UPDATES

[Vijon 'lufta' me flakët/ Situatë alarmante në Fier, digjen banesa dhe evakuohen familje! PAMJE ‘apokaliptike’ \(ZHVILLIME-VIDEO\)](#)

4 Shtator 2026, 17:57

LIVE UPDATES

[Përplasja te “Regina Palm”/ Arrestime dhe 2 versione për konfliktin: Bedinajt për gjobë, Muça për tokë! Reagon Rama](#)

4 Shtator 2026, 17:42

MOS HUMB

Aktualitet

[Çudia me konfliktin në Radhimë/ Gjykata lë në burg 3 truporjat e Muçës por liron qitësin e Vasil Bedinajt, Anxhelo Breshanin](#)

6 Shtator 2026, 15:40

Politikë

[Shqipëria në 'zjarr'! Denoncimet- Lapaj: Po e djegin ata që do të ndërtojnë! Arkitekti ndan hartën: Flakët në zonat e "Paketës së Maleve"](#)

6 Shtator 2026, 13:14

Aktualitet

[Të përfituara nga veprimatri kriminale? Lambo, Range Rover dhe Audi-Policia 'në sitë' makinat luksoze](#)

6 Shtator 2026, 13:24

ZËRI shpjegon realitetin ku jetojmë përmes dokumentarëve, hulumtimeve speciale, videove shpjeguese dhe elementëve multimedialë. Një grup profesionistësh të rinj mbulojnë çështjet e politikës, aktualitetit, ekonomisë dhe temave që ndikojnë direkt në jetën e njerëzve. Raportimi i bazuar në fakte është marka jonë unike. Ne vendosim standarte.
NIPT: M32126006Q

- [Të fundit](#)
- [Aktualitet](#)
- [Politikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Bota](#)
- [Opinione](#)
- [Energji & Mjedis](#)
- [Qytetërim](#)
- [Video](#)

•
•
•

- [CONTACT](#)
- [PRIVACY POLICY](#)

Redaksia Zëri:

Fjola Graçi

Fiona Ibrahim

Loreta Koleci

Zhuljeta Llani

Kristi Hoxha

